L’obiettivo di questo suo lavoro sviluppa due elementi: la parlata dei Paesi arbereshe e le frasi di gran parte degli scrittori arbereshe. Da questo punto di vista, in questo caso specifico, è la letteratura che va in soccorso del recupero del linguaggio. Quella letteratura che si è tramandata oralmente e quella letteratura di scrittori arbereshe che hanno lavorato conservando forme etimologiche e raccordi sintattici.

Ernesto Koliqi ebbe a dire, in una lettera del 31 luglio del 1963 indirizzata a Padre Giordano,: "Quello che rende più prezioso il Suo Dizionario è la fraseologia, che accompagna la definizione di ogni vocabolo, tratta dalle opere di Girolamo De Rada, Antonio Santori, Giuseppe Serembe, Giulio Variboba, Gabriele Dara, Giuseppe Schirò, Bernardo Bilotta ecc.. Ciò agevola anche ai più comuni lettori l'accesso al singolare mondo degli autori 'arbereshe', cui l'atmosfera bizantina, che ne impegna la spiritualità, dà un'impronta di viva suggestione”.

Infatti Giordano si serve della letteratura arbëreshe e questo diventa un fatto fondamentale perché è proprio attraverso i "linguaggi custoditi" oltre che a quelli sommersi che si recupera una identità linguistica e si ripristina il luogo del linguaggio comunicativo oltre al linguaggio simbolico e immaginativo. Infatti nella bibliografia pone in evidenza in ordine alfabetico gli scrittori arbereshe che sono quelli che hanno ereditato un modello di civiltà e lo hanno tramandato sul filo della tradizione. Un tassello straordinario che pone la ricerca di Giordano su due piani: quello etimologico e quello estetico. Così anche nella sua Grammatica, pubblicata come Ministero dei beni e delle attività culturali e del turismo, il lavoro è articolato e comparativo. Infatti egli ci fa capire come la lingua nella storia delle minoranze etnico - linguistiche ha sempre avuto un “portato” esistenziale, in cui la trasmissione dei valori della tradizione ha rappresentato un modello non solo di civiltà ma anche di confronto. Conoscere la lingua, in questi casi, in modo particolare, significa, tra l’altro, sentirsi dentro una comunità, appartenere ad una cultura e vivere l’elemento etnico con una consapevolezza che è, appunto, un modello di geografia umana. Perché la lingua ha il senso di ricontestualizzare il sentimento delle radici riappropriandosi di codici che offrono la possibilità di penetrare la vera umanità di un popolo. Proprio per questo motivo credo che sia importante indagare all’interno di quelle dimensioni linguistiche che permettono una conoscenza appropriata della storia di una comunità. La lingua chiaramente va difesa, va valorizzata, va veicolata.

Ci sono strumenti di conoscenza che bisogna incentivare. La storia Italo - Albanese si fonda su un bagaglio di istanze che provengono dalla tradizione, dall’arte, dalla letteratura, da quella antropologia che si completa con uno scavo nelle realtà delle archeologie. Un suggerimento che ha sempre posto la ricerca di Emanuele Giordano come riferimento negli studi, appunto, di comparazione anche di filologia linguistica.

La sua “Gramatikë Arbëreshe”, facendo riferimento anche agli studi correlati, ha lo scopo di entrare in questo vasto discorso perché si tratta di uno strumento necessario e importante di conoscenza, di diffusione

della lingua e di conservazione. La lingua, ci ha insegnato Giordano, costituisce un vero e proprio territorio ed è su questo territorio che si deve costruire un tessuto che passi inevitabilmente in una comparazione scolastica per raggiungere le nuove generazioni, le quali senza la conoscenza della lingua non potranno mai capire fino in fondo quel patrimonio identitario che è dentro il concetto di etnia (i popoli sono portatori di identità, non ci sono dubbi) che fa delle minoranze linguistiche non un popolo altro o diverso ma un popolo dentro la storia di una Nazione.

La lingua è un bene culturale. Le lingue minoritarie sono un patrimonio di culture in un confronto tra integrazione e identità stessa.

Cosa sarebbe la cultura Arbëreshe senza la sua lingua? Questo popolo e queste comunità potrebbero essere studiati dal punto di vista etnologico, antropologico, letterario, musicale ma senza una conoscenza del loro lessico, della loro grammatica (insomma dei loro codici linguistici), dei loro segni tangibili resteranno sempre dei vuoti, delle assenze, delle mancanze in una visione culturale in cui il conoscere è il sentire, il conoscere è il vivere. In fondo una lingua la si sente, la si impara e la si insegna. Così come nei lavori di Emanuele Giordano che ci offrono un “esercizio” storico e presente nella (o della) lingua Arbëreshe.

Il libro di base (chiamiamolo proprio così) resta sempre la grammatica. Una grammatica si completa sia con la storia sia con la letteratura di un popolo che offre civiltà. La lingua è contenuto e forma.

Ed è su questa cesellatura che una grammatica diventa il percorso per stabilire una corretta comunicazione. Per le comunità di minoranza etnica questo percorso resta fondamentale non solo dal punto di vista linguistico, come già si diceva, ma anche per una comprensione su una cultura che pone al centro quei radicamenti che hanno dato vita alla non perdita di quei valori storici che insistono nei contesti interessati. La lingua, è, dunque, un territorio. Storia e lingua è un rapporto imprescindibile con il quale si aprono prospettive di coerenza e di sussistenza. La cultura Arbëreshe si manifesta (come molte culture minoritarie) in un intreccio tra la definizione di una memoria che non può essere dimenticata e la parola che è sempre più un messaggio di trasparenza per comunicazioni che non vanno interrotte. Forse è proprio nel “reticolato” della cultura Arbëreshe che questi due aspetti (storia e lingua) si intersecano e danno vita ad un progetto articolato. Il “portato” esistenziale di cui si parlava è qui che trova il suo senso. La lingua, infatti, è l’esistenza di un popolo. Non ci si perde, se si difende e si tramanda la lingua. Non ci si perde se la lingua resta viva pur nella condivisibilità di un bilinguismo e nel rispetto dell’unità linguistica italiana come in più occasioni sostenuto.

La cultura Arbëreshe è dentro la cultura italiana. Così la lingua, la storia, le tradizioni, l’arte, la letteratura. In questo caso il bilinguismo per queste comunità è valore dell’integrazione oltre ad essere un sistema di conoscenza di una storia condivisa. La storia è continuità. Le realtà Italo - Albanesi hanno sempre partecipato alla armonizzazione di una storia comune e condivisa. La lingua è un “pensare” non diverso o altro (come si è già detto) ma forse è un “pensare” in più grazie ad una antica diaspora (che però non ha mai interessato l’Italia) che oggi non esiste più.

Ecco perché ha ragione di esistere una presenza linguistica degli Italo - Albanesi. Un ancoraggio in un futuro nel quale comunicare è conoscere. L’Arbëresh appartiene a quella storia d’Italia che ha saputo confrontarsi con i popoli del Mediterraneo - Adriatico. La lingua è nella geografia della storia e in considerazione di ciò si è convinti che tramandare è trasmettere ma è anche sapere educare attraverso strumenti certi. Gli strumenti dell’alfabeto. Emanuele Giordano ci addentra in questi strumenti. In realtà una grammatica racconta non solo la lingua ma struttura un linguaggio per un tracciato di apprendimento nel solco di quella memoria che non si cancella se la lingua stessa diventa un presente nel quotidiano.

Salvaguardia, tutela e promozione. Tre elementi sui quali si è basata la ricerca di Giordano e alla quale ha dato voce prima con le diverse riviste alle quali ha dato il suo notevole contributo e poi con i suoi intensi studi problematici. Una presenza che è un punto fermo nel panorama delle culture degli Italo - albanesi e resta un faro che sottolinea il senso della ricerca e una metodologia sia didattica che storiografica.

In fondo la sua ricerca si impone sul piano della lingua e su quello storico - letterario. Un mosaico dal quale dover ripartire per catturare il senso di una eredità diventata identità.

Atë Emanuele Giordano**Dom Lush Gjergji**

nga Prishtina

Atë Emanuele Giordano për herë të parë e kam takuar në Kalabri, në famullinë Ejanina në vitin 1970. Ishte Java e Madhe. Me ftesë dhe përcjellje të Mons. Eleuterio Fortino, së bashku me Don Ndue Gjergjin, Don Aleksandër Kolën, udhëtuam prej Romës për Kalabri. Ishim studentë të Universitetit “Urbaniana.” Qëllimi dhe synimi ynë ishte për t’i njohur dhe takuar vëllazëritë tanë Arbëreshë, “gjakun tonë të shprishur” gjatë shekujve, por gjithnjë të gjallë dhe të ngrohtë. Ishim mysafirë të familjes së Mons. Eleuterio Fortino, në fshatin e njohur San Benedetto Ullano, vendlindja e tij. Ai na kishte mundësuar këtë vizitë, takim, njohje me botën arbëreshe.

Ndër takimet e paharrueshme, përpos vizitave gati të gjitha bashkësive arbëreshe, riteve të liturgjisë lindore, ishte edhe takimi, ndeja, bisedimi me atë Emanuele Giordano, njeri i ngritur, me kulturë të lartë, njohuri të thellë dhe dashuri të madhe, me fytyrë tipike dhe karakteristike arbërore.

Na bëri përshtypje erudicioni i tij për gjuhë, histori, letërsi dhe kulturë shqiptare. Biblioteka e tij ishte plot me libra. Mendova dhe vendosa: në duar dhe bibliotekë të tij ka vend edhe për botimet tona, për revistën fetaro-kulturore DRITA, që kishte filluar botimin në Prizrenin tonë të lashtë.

Qysh prej takimit tonë të parë rregullisht ia kemi dërguar Dritën, më vonë edhe disa botime tjera, Roli i femrës shqiptare në familje dhe në shoqëri, Nëna jonë Tereze, Besëlidhja e Re... Çdo herë përgjigjej me fjalë të zgjedhura miradije dhe falënderimi, virtutet ky i njerëzve të mëdhenj dhe të mirë.

Takimi ynë i dytë ndodhi gjatë vizitës ndër Arbëreshë për mbledhjen e punimeve dhe krijimtarive kushtuar Nënës Tereze për monografinë “Lule për Nënë”. Ishim së bashku me Don Zef Gashin, famullitarin e atëhershëm të Prishtinës, tani arqipeshkvin e Tivarit, gjatë verës së vitit 1984.

Takimi ynë i tretë ishte prapë në Ejaninë, më 8 shkurt 1985. Me këtë rast ndër të tjera më tha kështu: “Ti ma dërgon rregullisht Dritën dhe shumë botime tjera ... Unë të kam borxh... Ja, pra, Fjalori i Arbërshtvet t’Italisë, 1963, fq. 592, me këtë përkushtim: “Mikut dhe Vëllaut të përdashur Lush Gjergjit. Me nderime dhe mall arbëresh. Papas Emanuil Jordani. Ejaninë, 8. II. 1985”.

Takimi ynë i katërt ishte me rastin e kremtimit të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë në Kalabri, ndër Arbëreshë (11-13 maj 2013). Isha së bashku me vëllain tim, Don Ndue Gjergjin, misionar te “Kisha Zoja Pajtores e Shqiptarëve” në Southfield të Detroitit.

Para një viti mësova nga nipi i tij Augustin Giordano, drejtori i revistës “Jeta Arbëreshe”, pjesëmarrës në Seminarin për Gjuhë, Letërsi dhe Kulturë Shqiptare në Prishtinë, se atë Emanuel Giordano fatbardhësisht ishte ende gjallë dhe mirë me shëndet.

E përhëndeta dhe ia dhurova disa libra, nëpërmjet nipit Agustinit, me dëshirë që të shiheshim sa më parë për t’i përtërirë kujtimet tona.

Mezi prita të takoheshim prapë, pas shumë viteve.. E gjeta në tavolinë të punës, të rrethuar me libra dhe shkrime. Ishte mjaft i freskët me mend dhe shumë i lumtur që rishtas ishim së bashku. I thashë: “Atë Emanuel, dashuria jonë është më e forte se koha dhe rrethanat e jetës. Ta solla edhe kësaj radhe një libër me meditime: “Të ftuar dhe të dërguar”.

Pas dy dite, u ktheva rishtas për ta parë dhe ftuar në manifestimin qendror të Pavarësisë së Shqipërisë. E gjeta me librin tim në tavolinë. Më tha: “Bukur, u kënaqa në lexim dhe meditim. Erdha deri te faqja 28. Gjithnjë lexoj ndonjë rresht, mendim apo faqe. Janë tekste të bukura dhe përmbajtjesore...”. U përgjigja unë: “Ti më do dhe shi për këtë edhe me çmon dhe nderon, I shijon edhe dromcat e vogla në sofër...”.

Pastaj ia shpjegova argumentin e ardhjes tonë dhe si në hoka i thashë: “Ti i përket asaj periudhe, sepse linde vetëm tetë vite pas Pavarësisë. Eja, pra, e na ndero me praninë dhe fjalën tënde!”.

Erdhi. Ishte shtrënguar mirë e mirë. Prania e tij i gëzoi shumë gjithë të pranishmit. I tha edhe dy fjalë rasti, dukshëm i emocionuar dhe ngazëllyer. Fjala e fundit ishte: “Urime, urime, dhe prapë urime!”.

Njeri për mrekulli në atë moshë! Mirë thotë populli ynë: “Nuk plakët zemra dhe dashuria!”.

Hera e pestë, e fundit, ishte kur pata përtëritjen shpirtërore për meshtarë dhe murgesha të Eparkisë së Ungrës, me ftesë të Imzot Donato Oliverio (14 – 15 maj 2014).

Atë Emanuele Giordano qetë, ndërroi jetë; kaloi në amshim, u kthye në shtëpinë e Atit më 17 shkurt 2015, duke lënë pas vete një histori, shumë kujtime dhe botime. Një jetë kushtuar Zotit, Kishës Katolike Bizantine, Popullit Shqiptar, sidomos Arbëreshëve; shembull atdhedashurie nëpërmjet kulturës së jetës dhe qytetërimit të dashurisë.

Miqësia dhe vëllazëria, komunikimi ynë tashmë vazhdon edhe në amshim.

Atë Emanuele Giordano ishte një prift arbëresh - i mirë dhe i njohur, mjaft i dalluar dhe afirmuar, intelektual i dorës së parë, i afërt dhe shumë i dashur, njeri që la gjurma të pashlyeshme në kulturën arbëroro-shqiptare, sidomos në lëmin e gjuhës dhe të liturgjisë. Zoti e shpërbleftë për shërbimin e madh flijues dhe dhurues, ndërsa kujtimi i tij lë të jetë ndër ne i gjallë dhe frymëzues për të gjithë, sidomos për brezet e reja. Pushoftë në paqe!

Prishtinë, 5 mars 2015

Vdekja e Zotit Emanuel Giordano

m.v. Odette Louise e Jesuit

nga Tirana

Vdekja e Zotit Emanuel Xhordano në klinikën e Ungrës më ka prekur thellë. Kisha mësuar për shkakun e shtruarjes së tij në spital, por duke njohur energjinë e tij shpresova që do të rimëkëmbej. Ky lajm ka qenë aq i vështirë për mua për arsye se prej kohësh kisha bërë plan ta vizitoja në qershor për ditëlindjen e tij, që është edhe imja: jemi lindur në të njëjtën ditë me ca vite ndryshim.

Njohja ime me Z. Emanuelin lidhet me themelimin e Vëllazërisë së motrave të vogla në fshatin e Ejaninës në Krahinën e Kozencës në vitin 1969.

Kujtoj me mallëngjim ditën e parë të takimit tim me Atë që ka qenë në të njëjtën kohë, një prift, një mik, një mësues, njëri ndër personalitetet arbëreshe më të shquara të epokës sonë. Ai punoi gjithë jetën e tij për të ruajtur dhe për të gjallëruar vlerat identitare të kombit dhe të fesë.

Kujtime gulfojnë spontanisht duke sjellë ndërmend këtë takim të parë. Ishte muaji i dhjetorit të vitit 1968 dhe motra e vogël Magdëlenë, themeluesja jonë, kishte vendosur për këtë udhëtim në Italinë e Jugut. Ajo shkruan në ditarin e saj "...duke pasur parasysh përgatitjen e themelimit të ardhshëm të një vëllazërie, qëllimi kryesor i së cilës ishte përgatitja për të hyrë në Shqipëri, gjë aq e vështirë në atë kohë". Ajo kishte marrë një kërkesë nga një prift bizantin nga katundi Firmozë; i cili dëshironte që motrat e vogla të vinin në famullinë e tij. Përpos kësaj një arbëreshe, Maria Delfina e prejardhur nga ky fshat kërkonte të hynte te Motrat e vogla, dhe në të njëjtën kohë unë, kërkova të përgatitesha për Shqipërinë. Kjo përkitje qe për motrën e vogël Madëlenë një shenjë. Duhej të shkonin për t'i njohur këta italo-shqiptarë.

Ishim dy për tu nisur për rrugë për në Kalabri. Duke bërë pjesë në Sektorin "Est" dmth, të vendeve komuniste, dëshironim të shkonim në mision në vende nën regjimet marksiste. Papas Matrangolo na përcolli dhe vizituam shumë fshatra arbëreshe të Krahinës së Kozencës. Arritëm në fshatin e Ejaninës: ishte dimër, dhe mjegulla zvarritej nën një grumbull shkëmbinjsh të mëdhej, të cilët më dukej se ishin të gatshëm për të na mbuluar, krijonte një atmosferë të mistershme përpara një gjëje të panjohur. Më duket se e shoh akoma kishën e vogël bizantine që më joshi, sepse ishte edhe dëshira ime ta njoh më mirë këtë rit. Z. Emanueli na priti në një dhomë të madhe ngjitur me kishën, që shërbente si zyrë pune dhe vend pritjeje. Ai vuri karrige afër vatrës dhe hodhi ca copë druri për të prushitur zjarrin. Sytë e mi drejtoheshin nga harta e Shqipërisë e varur në një mur dhe kjo ngjalli kureshtinë time, duke pasur dëshirën se një ditë do të kem mundësinë të shkoj në këtë vend të panjohur, ku bënte kërdi një përndjekje e tmerrshme kundër të krishterëve. Ai na foli për origjinën arbëreshe të katundit të tij, për ritin bizantin të ruajtur nëpër shekuj, ndonjëherë me shumë vështirësi dhe luftë, për varfërinë e banorëve dhe sidomos për gjuhën e arbëreshëve, shqipen. Kemi pasur një bisedë të gjatë, ai na dëftoi Fjalorin arbërisht-italisht që kishte përpiluar dhe na e dhuroi një ekzemplar. Kishte edhe përkthyer liturgjinë e Gjonit Gojëartë në arbërisht, dhe e këndonte çdo mengjes në Kishë. Ai na tregoi edhe një foto të kalasë së Shkodrës dhe na foli shkurtimisht për udhëtimin që posa kishte bërë në Shqipëri i ftuar nga autoritetet shtetërore të RPSH në rastin e botimit të fjalorit të tij. Ai na tregoi edhe për trishtimin që kishte përjetuar, duke vizituar njërin nga shokët e tij të studimit, kur ishte në Grottaferrata. Ky prift ndodhej në një gjendje të tmerrshme, kishin mundur të bisedonin shumë pak në praninë e "sigurimit"...

Brenda pak kohe Zoti Emanuel na futi në historinë e Shqipërisë, nëpër odisenë e arbëreshëve, duke na treguar me krenari medaljen ari që kishte marrë në rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit, Skënderbeut.

Thehtësia e mendimit të tij dhe qëndrimi i tij shpirtëror na bënë shumë përshtypje. Ai ishte gati të na pranonte, kuptonte thirrjen tonë kontemplative në mes të botës, me një dëshirë solidariteti dhe ndarjeje me popullsinë që jetonte në kushte të pasigurta të punës bujqësore. Thjeshtësia e tij, banesa e tij modeste dhe mënyra e të folurit të hapur ngashënyen simpatinë tonë. Nuk dija ende që isha në praninë e një shqiptari të Kohës së Madhe të Gavril Darës. .. Më vonë mësova që ungji i tij Bernard Bilotta kishte përshkruar kujtesën e kësaj kohe në librin e tij: "Shpata e Skenderbeut". Kisha parandjenjë se do të vijmë prapë për ta filluar aty një vëllazëri, duke pritur hapjen e Shqipërisë si e shkruan Motra e vogël Madëlenë në ditarin e saj të 21 mars 1969: "Shpresa e themelimit në një rit lindor dhe në përgatitje për të hyrë në Shqipëri është një gëzim i dyfishtë".

Pasi arritën në Ejaninë të parat motra të vogla, Zhoze Zhaninë e Maria Lucia banuan në një familje duke pritur ta gjejnë një shtëpi. Ato filluan ta studionin gjuhën shqipe te Z. Emanuel, i cili u dha atyre jo vetëm njohuritë e para për të kuptuar liturgjinë bizantine, por ua mësoi atyre shqipen dhe këngë. Pas kontakteve të ngrohta me Imzotin Stamati të Eparkisë së Ungrës, Vëllazëria u themelua zyrtarisht dhe motra e vogël Madëlenë do të vinte në Ejaninë në fillimin e tetorit, e lumtur për këtë prani në ritin lindor dhe për ndjenjat e një simpatie të arbëreshëve ndaj kardinalit Tisserand, mik i madh i Vëllazërisë së motrave të vogla. Ajo shënon: "...me prapamendim të përgatitemi për të hyrë në Shqipëri".

Shumë motra të vogla do të vijnë në Ejaninë, me shumë entuziazëm ato do të zbulojnë një tjetër pamje të Italisë, atëherë shumë pak e njohur, duke dëshiruar ta ndajnë jetën e banorëve në marrëdhëniet e përditshme të punës dhe të fqinjësisë: nuk fiket kurrë kujtimi i "gjitonisë", që bashkonte shoqërinë e lagjes... Gjithnjë me të njëjtin entuziazëm, me të njëjtën energji Z. Emanuel priste motrat e vogla, ua mësonte atyre këngët liturgjike dhe ua shpjegonte trashëgiminë humane, shpirtërore dhe kulturore të gjallë në traditën folklorike. Ai diti të përçonte dashurinë e popullit të vet te motrat e vogla, t'ua mësonte gjuhën e vendit të tij të parë, veçoritë e arbërishtes, të të folmeve të ndryshme dhe pasurinë e liturgjisë bizantine. Frytet e zellit të tij do t'i rigjejnë te motrat e vogla që do të vazhdojnë misionin e tij:

- Një ekspozitë shumë e bukur të veshjeve të gruas arbëreshe: "Shpirti mbretëror te veshjet e gruas arbëreshe" u sendërtua në Ejaninë falë kreativitetit dhe punës së zellshme të ps Liçia. Kjo ekspozitë do të paraqitej edhe në Shqipëri në Festivalin e Gjirokastrës në 1988. Këto kuklla, me veshje shqiptare të grave arbëreshe kur erdhën në Itali, si pasojë të pushtimit osman, do të jenë ambasadore shpirtërore të vëllazërisë dhe të paqes në një Shqipëri atëherë e vuajtur nën tiraninë komuniste, dhe ata do të na japin mundësi të lidhim kontaktet e para me Shqipëri.

- "Bashkësitë arbëreshe, dëshmi të etnosit shqiptar", rezultati i gjurmimeve në bashkëpunim me Zotin Emanuel, të vlefshëm dhe të palodhshëm, sidomos për të dhënë shpjegime në lidhje me gjuhën shqipe, do të hapin ardhmërinë e arbëreshëve drejt Kosovës dhe pastaj Shqipërisë. Ejanina që vërtet Dera, e parandjerë nga motra e vogël Madëlenë

Të gjithë motrat e vogla drejtojnë një këngë falënderimi dhe mirënjohjeje ndaj Zot Emanuelit dhe Arbëreshëve që kemi njohur dhe njohim.

(Tiranë më 09.03.2015)

- 1) Gavril Dara i Ri, Kënga e sprasme e Bales, Palermo 1906;
- 2) Bilotta Bernardo, Shpata e Skenderbeut në Dibrët poshtë, Tiranë 1968.

Studiues i shquar i dijes arbërore

prof. dr. Imri Badallaj

(nga Zhuri)

Protopapas Emanuil Jordani, ky doajen i dijes, që në fillimet e viteve të pesëdhjeta jetoi arbëreshitetin e tij në mënyrë intensive dhe të jashtëzakonëshme. (...) Veprat e plota, që këtu na po përmendim (1957- *Folklore albanese in Italia, tip. Melomo, Cassano; 1963- Fjalor i Arbëreshëve t'Italisë (Dizionario degli Albanesi d'Italia, Bari; 1967- Shpata Skënderbeut ndë Dibrët Poshtë, e Binard Bilotës, Tiranë; 1972 – 1982 drejton revisten Zëri i Arbëreshvet, Ejaninë (Cs); 2000 – Vangjeli i Shën Matesë, Kozencë; 2000- (me të tjerë) Alfabetizzazione Arbëreshe, Torino; 2000 - Fjalor (Dizionario Arbëresh-Italiano / Vocabolario Italiano-Arbëresh, Castrovillari; 2005 - Himne liturgjike bizantino-arbëreshe, Castrovillari; 2005 - Gramatikë arbëreshe, Manduria; 2006- Mbledhje këndimesh arbëreshe, Castrovillari; 2006 - Vangjeli i pjerrë arbërisht, Cosenza), tregojnë qartë për një opus të madh krijues dhe shkencor, që ka kapur segmente e fusha të dijes, që shumica prej tyre kanë qenë të paprekura. Mirëpo, jo vetëm kaq, ngase në tryezën e tij të punës i mbante para vetes edhe pesëgjashhtë tituj librash në dorëshkrim, të cilët ndërkohë do t'i publikonte. Por... pas një sëmundje të shkurtër, në fjavat/shkurt të këtij viti u nda nga kjo jetë dhe penda e tij mbeti e ngrirë mbi ato letra, që gjithmonë i mbushte plot e përplot, duke kapur çështje shkencore nga disa fusha të dijes, si në leksikologji, në gramatologji, në etnolinguistikë, në dialektologji, në sociolinguistikë, në folkloristikë, në tekstologji, në muzikologji; dhe sidomos në fushën e përkthimit ishte më i veçanti. Pra, protopapas Emanuil Jordani pos misionit të tij si klerik, ai u shqua në shumë segmente të dijes, që këtë ia mundësoi edhe njohja e shkëlqyeshme e disa gjuhëve të huaja. Prandaj, edhe titujt e veprave të vëna këtu më sipër tregojnë qartë, se Emanuil Jordani ka lënë pas vetes vepra që prekin pikat më të ndjeshme të trungut të shkencës arbërore, që gjithsesi për të arritur në përfundime të drejta dhe të sakta, duhej jo vetëm dije, por edhe durim e mund i paskajshëm, që pa dyshim këtij dijetari këto tipare nuk i mungonin. Pra, Jordani qe intelektual me përmasa të mëdha. Këtë më së miri e dëshmoi penda*

Tri takimet e mia me 'Zotin Lalë'

prof.dr.Bardh Rugova

Universiteti i Prishtinës

Herën e parë e takova zotin Lalë në formën e një fjalori të arbërishtes në tryezën e punës të mentorit tim, prof. dr. Imri Badallajt. Pas këtij takimi do të njihesha edhe me gramatikën e tij të arbërishtes, me përkthimet e tij të ungjijve dhe me përmbledhjet e këngëve arbëreshe. Do të njihja veprën e një studiuesi, leksikografi, gjuhëtari, përkthyesi, folkloristi dhe, mbi të gjithash, intelektual.

Herën e dytë, njëzet vjet më pas, e takova zotin Lalë për herën e dytë: këtë herë një takim për së gjalli. Ishte në studion e tij në Ejaninë. E pashë një burrë të moshuar, të kërrusur mbi libra që po shfaqte hare para mysafirëve kosovarë. Në moshë të thyer, ai të thoshte përmendësh vargje poezish, shpjegonte për gjuhën arbëreshe dhe i shkante një pikë loti nga ngashnjimi e krenaria, për nipat e tij, Agostinin, studiuesin dhe publicistin, dhe Vasilin, senatorin. Lajmi për ikjen e tij më dha dhimbje, por edhe prehje e ngushëllim, për faktin se nuk shuhen njerëzit, të cilët i mbijeton vepra.

Herën e tretë po e takoj tani zotin Lalë, në formën e një vegimi dhe të një shëmbëlltyre; në formën e kujtesës dhe të ndikimit të veprës së tij prej studiuesi e dijetari. Ky është edhe takimi më i gjatë me imzot Emanuil Jordanin: është takimi me jehun e veprës së tij në përjetësi.

e tij, e cila, kudo që u ngul, u shqua për thellësinë dhe gjerësinë e kapjes së problemeve, për fuqinë e analizës dhe të sintezës së çështjeve, për konkluzionet bindëse, për kriteret e rrepta shkencore, që zbatoi në rezultatet e arritura në fushën e kërkimeve dhe të hulumtimeve, që gjithsesi këto rezultate pa u luhatur do t'i qëndrojnë dhëmbit të moteve.

Nga kjo që u shtrua lart, del qartë se ky intelektual dhe studiues serioz me shumë objektivitet i ka krijuar vetes një vend të denjë në majat e dijes dhe të shkencës në përgjithësi, që si i tillë do t'i mungojë jo vetëm familjes dhe të afërmeve të tij, por të gjithë neve, që e njohëm me tërë veprat, që i la pas vetes.

"...Se të përhapjen edhe të përjetësojën gjuhën shqipe..."

(protopapas Emanuele Giordano)

dr.prof.Merita Sauku-Bruçi

Universiteti i Tiranës

E takova për herë të parë në vitin 2007, në një kuvend të organizuar në katundin e Çiftit (Civita), mbi poezinë italiane bashkëkohore të përkthyer në shqipe, ku u promovua edhe një antologji e poetëve italianë në shqipe. Zoti Emanuele, kështu e thërrisnin, rrezantonte një mirësi që të depërtonte thellë në shpirt. Megjithë moshën e shtyrë kishte energjinë dhe çapin e një djaloshi. Kisha dëgjuar shumë për të, kisha lexuar shumë punime të tij, përdorja si libër pune çdo ditë Fjalorin e hartuar prej tij. Kjo më bënte të ndjehesha e emocionuar dhe të përjetoja një admirim të veçantë. Admirimin dhe respektin që një rishtarë në lëmë të filologjisë arbëreshe provon për një mjeshtër që i kushtoi jetën ruajtjes dhe dokumentimit të arbërishtes.

U bënë mëse dhjetë vite që merrem intensivisht me arbërishten e dokumentuar, dhe në vizitat e mia të shpeshta në katundet arbëreshe e në takimet e shumta me studiues, mësues, gra e burra arbëreshë kam kuptuar se tri janë shtyllat ku mund të mbështetemi që kjo trashëgimi historike, zakonore, gjuhësore, letrare e kulturore e arbëreshëve, e sjellë deri në ditët e sotme të mos tretet: familja (nënat në veçanti), besimi fetar dhe shkolla. Në fakt këto janë edhe tri drejtimet kryesore ku mund të kanalizohet edhe kontributi i Zotit Emanuele për atdheun e tij italik e mëmëdheun e tij ballkanik.

“- Me se merresh, bijë?

– Me Santorin Zot, po transkriptoje dorëshkrimet e romanit Sofia e Kominiatëve.

-Ah Santori, na duhet ta njohim më mirë. Është shkrimtar i madh.”

Dhe filloi të më recitonte vargjet satirike të Mjekarit-ndërsa më dhuronte librin e tij të sapobotuar.

Ndë ultare si një nuse, / t'ulën, t'ndreqën Separjeli, / ta shtron mbësallën e ti kërruse /si një koqez krikomeli; kur me gjishtrat pra të nget, / duket se t'herën e t'vret.”

Zëri i tij më vinte si muzikë. Sytë i shkëlqenin dhe nuk ishte e vështirë të dalloje pasionin për punën që bënte për të mbledhur, riprodhuar, incizuar e transkriptuar këndimet popullore të Ejaninës, Frasnitës dhe jo vetëm. Këtë poezi satirike të Santorit e kishte përfshirë në botimin *Mbledhje këndimesh arbëreshe (çë këndohen Ejaninë e Frasnitë, 2006)*. Botimi paraqet disa rapsodi popullore, këngë që Zoti Emanuele kishte njohur në vogëlinë e tij, këngë të gjegjura e të kënduara nga gratë e Ejaninës e të Frasnitës, këngë korale të Valljeve të incizuara e të transkriptuara në muzikë, etj. Nuk e braktisi kurrë shpresa që: *kjo mbledhje do të begatënj ndërtesën këngëtare e Arbëreshevet të Italisë, çë kanë ditur t'e ruajin me kujdes dhe t'e trashëgojin me kujdes të madh dhe të trashigojin me vullnet të fortë këtë pasuri kulturore.*

Botimi i *Vangjeli-t në 2006* (Vangjeli – i pjerrë arbërisht nga zot Emanuele Giordano – suplemento a “Jeta Arbëreshe”, nr. 50/ 2006) në 60-vjetorin e famullitarisë së tij, përmbushi një dëshirë të brendshme e të gjith'hershme të klerikut: *Libri më i Shëjtë i të Krishterëve t'i vej ndër duart e Arbëreshëve. Se të jenë, çdo ditë Arbëreshë dhe të Krishterë të vërtetë.* Me katër pjesët përbërëse të tij *Vangjeli sipas Mateut* (f. 5-70), *Vangjeli sipas Markut* (f. 71-111), *Vangjeli sipas LLukës* (f. 114-180) *Vangjeli sipas Janjit* (f.181-230) ky përkthim i Librit të Shenjtë tejkalon dhe plotëson botimet e Kamardës dhe Dorsës dhe të tijin (2000) e u mundëson arbëreshve t'i dhjavesën, t'i mejtojën.

Interesant është edhe propozimi gjuhësor që Zoti Emanuele paraqet në këtë përkthim. Bëhet fjalë për mundësinë e pranimit të një gjuhe të përbashkët, ose arbërishte standard, e cila i qaset shumë gjuhës shqipe, aq në gramatikë, sa në sintaksë e leksik . Në këtë gjuhë është pjerrë ky Vangjel. Kur fjalët s'i gjeta tek të folmet arbëreshe i mora nga gjuha shqipe. Një propozim gjuhësor që realizon në praktikë një “frymë”, e cila përshkon edhe disa vepra të hartuara prej tij apo që mbajnë firmën e bashkëpunimit me autorë a studiues të tjerë. Ai u përpoq për një udhë “të mesme” duke eksperimentuar një të folme më të mirë arbëreshe, pra një të folme të përzgjedhur nga format më të pastra morfologjike apo sintaksore, me variante leksikore të vjetra, duke shmangur format e ndikuara nga kalabrishtja apo italishtja. Në mungesë të formave në të folmen

e një katundi, mori forma nga të folmet kufitare, duke e zgjeruar rrethin dalëngadalë gjeografikisht, e në fund fare kur nuk gjeti forma gjegjëse i mori nga shqipja e sotme. E ndoqi këtë rrugë edhe në hartimin e *Gramatikës arbëreshe* (2005), të *Fjalorit arbërisht-italisht* (1963 dhe i ribotuar i plotësuar më vonë) si dhe në tekste të tjera për mësimdhënien e arbërishtes. E kanë përdorur edhe disa autorë (Fortino, A. & E. Giordano, Stamile, Tocci, Bruno) në një bashkëpunim për hartimin 2 vëllimeve të botuara në vitin 2000 “*Alfabetizzazione arbëreshe*” si manuale që përveç se shërbejnë për të mësuar leximin dhe shkrimin e arbërishtes, japin njohuri edhe në lëmë të historisë, letërsisë, folklorit, muzikës dhe ritit bizantin. Të dy vëllimet janë të shkruara në arbërisht; vëllimi i parë shoqërohet edhe me përkthimin italisht, vëllimi i dytë vetëm në arbërisht, pa përkthim. Është një metodë që parashikon transmetimin e njohurive nga më e thjeshta tek më e vështira.

Qasje vizionare apo utopike ndaj problemit? Vetëm koha dhe vullneti i vetë arbëreshëve për mbijetesë gjuhësore mund t'i japë një përgjigje kësaj pyetjeje.

Takimi im i fundit me Zotin Emanuele qe në 2011, kohë kur ishte i shtruar në një klinikë rikuperimi në Lungro. Shoqëroja në këtë vizitë profesorin dhe mentorin tim, Italo C. Fortinon. Koha dhe sëmundja kishte lënë gjurmë në fizikun e tij, por zëri dhe vështrimi ishte po ai.

Do të doja të paraqisja në fund të këtij shkrimi, këtë sonet të shkruar nga F. A. Santori dhe që është shkëputur nga letra dërguar De Radës në 1 maj të 1843. Është mënyra më e mirë për të falenderuar dy burra, klerikë e letrarë njëherazi, që në shekuj të ndryshëm u përpoqën për të njëjtin qëllim, shkrinë të gjithë jetën e tyre, larg çdo rendjeje pas famës, për të përjetësuar një trashëgimi gjuhësore të çmueshme: Arbërishten.

Botohet për herë të parë sipas fl. 22 F.24, D.54/9. në Arkivin Qendror të shtetit Tiranë.

Kangjelijë

*Ndo bumblizon te dheu shërbia ime
Pantehjinjë u se piallë shum thamasī,
Pëse ndo ndianë me veshë, ndo ruanë me sī
Së gjegjën o sheh mose dheza shërtime*

Klara Kodra
nga Tirana

Emanuel Xhordano-s

In memoriam

Rënduar kryet me togje bore,
Ndezur prej zjarri sytë e thellë,
Në detin e rrudhave pleqërore
Buzëqeshja – copëz diell.

Si bujku në arë lëvroje fjalën,
Fjalën që ushqen dhe kurrë s'të vel,
Dhe zemrën ndaje me bashkëfshatarët,
Babë Emanuel!

Kurrë s't'u lodh së hedhuri ajo dorë
Në arë të bardhë farën e zezë.
Duajt e fjalëve u bënë FJALOR,
Duajt e artë lëshuan rreze.

Dritën e ditës e veshi një vel
Kur ti na ike e s'na erdhe më.
Malli për ty, Babë Emanuel,
Na djeg, s'na lë.

Ti ura fjalësh ngrite mbi det ...
Ike, të thirri Ati i Amshuar,
Ike e na le të gjithëve një amanet:
Kjo Fjala shqipe qoftë e pushuar!

*Oh! Të noeronjë se kjo zëmër' e brime
Së prët prë zae formadhe ndonjë hajdhī
Shkruajti se të nderoj gjuhën arbrī
E s'do më se këtë; nderë o llautime*

*U pres e zëmëra tas ndë gjī gjëmōn
E trëmburë! Çë? Ndo jan llautuora o shara
Së kam spiaxhirë: ndo prapa meje rron*

*Skontrepsturë imi ëmërë [...] prë ndherë të
Të ventit ku gjellonjë; ljetë të rara
S'u pane nka sitë e mia pr'a[...]rë një herë!*

“Fjalori i Arbëreshëvet t’Italisë” (1963, 2000) i papas Emanuele Giordano-s

Një vepër me vlerë të përhershme

dr. prof. Emil Lafa

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Botimi i veprës “Fjalori i Arbëreshëve të Italisë” i papas Emanuele Giordano-s më 1963 ishte një risi e papritur dhe e mirëseardhur për leksikografinë shqiptare. Mbaj mend se lajmi ngjalli interesim të veçantë në Institutin e Gjuhësisë. Kam dëgjuar atëherë në Institut se papas Emanuili ishte drejtuar autoriteteve shtetërore të Shqipërisë që të blinin një sasi kopjesh të fjalorit edhe për të lehtësuar detyrimin e tij ndaj shtypshkronjës. Në përmbushje të kësaj kërkesë u blenë 500 kopje të fjalorit për bibliotekat dhe për shitje në librarinë ndërkombëtare të Tiranës. Dua të përmend me këtë rast se shteti shqiptar ka qenë gjithnjë i ndjeshëm ndaj Arbëreshëve matanë detit dhe ka mbajtur hapur rrugë komunikimi e bashkëpunimi me “Gjakun tonë të Shprishur”. Arbëreshët janë vështruar si bij të “Motit të Madh” të Skënderbeut dhe dashuria e nderimi për ta e për burrat e shquar që kanë nxjerrë, është rrënjësor si një edukatë kombëtare në atdheun e tyre të hershëm. Të gjithë shqiptarët janë të vetëdijshëm për rolin e madh të Arbëreshëve në Rilindjen Kombëtare dhe në ndërtimin e kulturës moderne shqiptare.

Burimet e fjalorit dhe fjalori si i tillë.

“Fjalori i Arbëreshëve të Italisë” i E.Giordano-s është një vepër leksikografike e shënuar mirë dhe e hartuar mbi kritere shkencore. Duket se autori e ka bluar në mendje mjaft herët mendimin për këtë fjalor dhe ka punuar gjatë për të. Këtë e dëshmojnë burimet e shumta që ka vjelë dhe që i ka cituar në fjalor, duke dokumentuar fjalën dhe kuptimet e saj. Pra nuk kemi të bëjmë me një vepër të nxjerrë thjesht nga shënime të rastit, nga kujtesa e nga njohja vetjake e të folmeve arbëreshe, por me një vepër të mbështetur në dokumente të shkruara, thuajse në gjithë veprat e botuara deri atëherë të letërsisë dhe të publicistikës arbëreshe, si dhe në materiale të lëna në dorëshkrim. Ky fjalor ku fjalët e shprehjet arbërisht/shqip shpjegohen me fjalët e shprehjet përkatëse të italishtes, të kujton kështu fjalorin e K. Kristoforidhit (1904) me shpjegime kryesisht në gjuhën greke dhe fjalorin e “Bashkimit” (1908) me shpjegime italisht. Meqenëse fjalori i drejtohet kryesisht një bashkësie etnike dygjuhëshe, ku arbërishtja është gjuha e vatrës dhe e zemrës, kurse italishtja gjuha e shkollës, e kulturës dhe e punëve për të fituar jetesën, autori ka vepruar drejt me këtë zgjedhje. Fjalori pasqyron realitetin gjuhësor të ngulimeve arbëreshe në Itali, ku që nga gjysma e dytë e shek. XX që të gjithë janë praktikisht dygjuhësh.

Burimet e fjalorit janë gjuha e shkruar dhe gjuha e folur e përditshme. Si burime nga gjuha e shkruar autori shënon: a) vepra të botuara e dorëshkrime të autorëve arbëreshë (35 autorë duke filluar me L. Matrangën), b) revista e përmbledhje shkrimesh arbëreshe (duke përfshirë edhe botime të Shqipërisë në vitet 1954-1961); c) fjalorë dhe gramatika të gjuhës shqipe, ndër to edhe “Fjalori i gjuhës shqipe” i Institutit të Shkencave (1954) dhe “Gramatika shqipe” e Kostaq Cipos (1949). Krahas këtyre burimeve të shkruara fjalori pasqyron edhe përvojën e pasur jetësore të autorit si njohës i gjithanshëm dhe studiues i vëmendshëm i ligjërimeve arbëreshe dhe si lëvruar i arbërishtes sidomos në fushën e liturgjisë.

Pra është e qartë se ky fjalor, megjithëse në titull përcaktohet si i Arbëreshëvet të Italisë, nuk përfaqëson vetëm leksikon dialektor të ruajtur në ngulimet e tyre ose të krijuar atje qoftë në mënyrë anonime nga gjindja e thjeshtë, qoftë nga burrat e shquar të penës, që kanë dalë nga gjiri i saj. Autori i ka dhënë fjalorit një frymëmarrje më të gjerë në pajtim dhe me idenë e tij për shërbimin e kësaj vepre. Është e njohur se bota intelektuale arbëreshe i ka pasur gjithnjë sytë nga Arbëria matanë detit (*Arbëria matanë detit na kujton...* Serembe) dhe ndërmjet dy brigjeve ka vepruar një osmozë kulturore e shëndetshme, veçanërisht që me fillimin e shek. XX. Në këtë mënyrë fjalët e përdorura në shtypin dhe botimet e shqiptarëve të këtejshëm u bënë të njohura dhe nisën të përdoren edhe andej.

Nëpërmjet këtij fjalori mund të hetohen edhe lidhjet e shkrimtarëve e të publicistëve arbëreshë, veçanërisht që nga shek. XIX, si J. De Rada, D. Camarda, V. Dorsa, B. Bilotta, A. Lorecchio, A. Santori, G. Schirò (i Riu), G. Serembe e të tjerë me letërsinë dhe publicistikën e autorëve shqiptarë si dhe pasurimi i gjuhës së

autorëve arbëreshë me fjalë të trojeve shqiptare e të autorëve shqiptarë. Kështu në këtë fjalor gjejmë fjalë të tilla, si: *atdhe, atdhetar, cofhtë (i), dashuri, frikakac, gjerësi, hjekës, krenar, kreni, krishtlindje, malësi, mashkullor-e, mbinatyrshëm (i), mbishkrim, mohoj, nënqeshje, nënshkruanj, pazakonshëm (i), përparonj, përparshëm (i), përqaqonj, rrjedhim, shpërblim, shpërblimtar, shpërfytyronj, shpërthenj, trimni, trimnisht etj.etj.*, të përdorura në vepra të autorëve të sipërpërmendur ose në botime të ndryshme arbëreshe. Krahas tyre autori e ka quajtur të arsyeshme të përfshijë në fjalor edhe mjaft fjalë të tjera të shqipes letrare, të cilat mund të ndeshen në botime të ndryshme shqip, si *atdhetari, gjatësi, nëndheshëm (i), nënshkrim, i nënshkruar, nënkryetar, nënshtrim, nënshtronj, ribashkim, ribashkonj, shpërndarës, shpërndarje, shpirtmadhësi, shpirtmirësi, ujitje, yndyrë etj.* Dhe kështu një fjalor *i Arbëreshëve të Italisë* do të ishte detyrimisht edhe një fjalor *për Arbëreshët e Italisë*, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë fjalët e gjuhës shqipe që përdoren në atdheun e lashtë.

Dobia e fjalorit.

Ky fjalor është hartuar si kërkesë e kohës dhe me synime të caktuara. Pas Luftës, në Republikën Italiane me institucione demokratike, po hapeshin pak nga pak perspektiva për një gjallërim të mëtejshëm të jetës kulturore dhe të mësimin të gjuhës amtare në fshatrat arbëreshe. Një brez i ri po rritej me shpejtësi dhe dëshira për të ruajtur rrënjët e vjetra kulturore e sidomos gjuhën, ishte mjaft e shprehur. Një rol të veçantë ka luajtur edhe kisha arbëreshe në fshatrat që kishin ruajtur ritin bizantin, ku krahas italishtes e greqishtes, përdorej edhe gjuha vendëse në liturgjitë e në ceremonitë e ndryshme fetare. Ndërkaq, nga ana tjetër e detit, në Shqipëri dhe në Kosovë, në shkollat e mesme e të larta mësoheshin shkrymtarët arbëreshë dhe veç antologjive shkollore, po botoheshin edhe vepra të veçanta të tyre, gjithashtu filluan të hartoheshin studime gjuhësore e letrare për to. Letërsia arbëreshe gjithnjë është vështruar dhe trajtuar si pjesë përbërëse e pandashme e letërsisë shqipe a shqiptare dhe me këtë ajo është bërë një element i qenësishëm në formimin kulturor të inteligjencies shqiptare. Të gjitha këto shpjegojnë pse fjalori i Emanuele Giordano-s që i mirëpritur dhe 500 kopjet që erdhën në Shqipëri, u shpërndanë e u shitën në pak kohë. Fjalori u bë i njohur shpejt edhe në Kosovë me recensionet e botuara nga prof. Idriz Ajeti e më vonë edhe Mahmut Hysa, ndërsa në Shqipëri nga studiuesi i njohur letërsisë arbëreshe Jup Kastrati. Pa dyshim papas Emanuili kishte hartuar një vepër të dobishme e të nevojshme, që mori shumë vlerësime. Për Arbëreshët ky fjalor që vepra më përfaqësuese e pasurisë leksikore e frazeologjike të ligjëtimeve të tyre, të cilën ata e njihnin vetëm pjesërisht, secili sipas fshatit a krahinës së vendlindjes.

Fjalori i E. Giordano-s ka qenë i njohur e i përdorur në Botën Arbëreshe, siç kam pasur rastin ta vërej vetë, në gusht-shator 1980, kur së bashku me kolegun Veli Bici dhe Franko Altamarin, zhvilluam për pesë javë një kurs të gjuhës së sotme shqipe me mësues dhe banorë të tjerë të fshatrave në Bashkësinë Malore të anës së djathtë të lumit Krati (Comunità Montana Destra Crati). Shumë nga pjesëmarrësit e kursit vinin me fjalorin e E. Giordanos me vete dhe nëpërmjet tij saktësonin më mirë kuptimet e fjalëve që njihnin e njëkohësisht mësonin edhe mjaft fjalë të reja, sidomos fjalë të shqipes së sotme letrare. Pikërisht duke u nisur nga shërbimi i këtij fjalori si mjet për të fituar një kompetencë më të lartë në zotërimin e shqipes, - dhe nga rrethana se prej vitit 2000, pas aprovimit të Ligjit kombëtar 482/99 mbi Pakicat Gjuhësore Historike të Italisë, në shkollat e Fshatrave Arbëreshe mësohet edhe Arbërishtja, në formën e së Folmes Arbëreshe të çdo fshati - E. Giordano, në ribotimin e fjalorit në vitin 2000, shtoi si pjesë të dytë një fjalor italisht – arbërisht me rreth 11.000 fjalë. Me këtë formë të plotësuar kjo vepër ndihmon më mirë nxënësit dhe të tjerët, për të gjetur fjalët arbërishte (shqipe), që nuk i dinë.

Te ne ky fjalor, ashtu siç e kishte parashikuar vetë autori, ka ndihmuar dhe ndihmon për të lexuar autorët arbëreshë, për të pajisur me shënime filologjike botimet e veprave të tyre, që “studiohen sot më shumë se kurrë më parë” (Parathënia, f. IX). Fjalori është njëkohësisht edhe një mbështetje e sigurt për dokumentimin e fjalës e të kuptimeve të saj në ligjërimet e në letërsinë arbëreshe. Në “Studimet etimologjike” të E.Çabejt ai citohet me dhjetëra herë, po ashtu në studime të tjera.

Leksiku i arbërishtes dhe shqipja e sotme.

Fjalori përmban rreth 19.000 fjalë dhe një pasuri të madhe shprehjesh e fjalësh të urta, që karakterizojnë

jetën dhe zakonet e Arbëreshëve të Italisë. Vetë autori është edhe studiuesi i parë i fjalorit të tij. Çështja që tërheq më së shumti vëmendjen është ballafaqimi i fjalorit të Arbëreshëve me shqipen e sotme. Sipas ballafaqimit që ka kryer ai vetë të lëndës leksikore arbëreshe me fjalorët e shqipes, del se rreth 45% të leksikut popullor arbëresh janë të përbashkëta me shqipen. Kësaj i duhet shtuar edhe ajo sasi jo e vogël fjalësh që shkrimtarët arbëreshë kanë huazuar nga shkrimtarët shqiptarë, siç u përmend më lart, e që përbëjnë rreth 5%. Më tej autori shënon se rreth 5% e përbëjnë fjalët e rralla të përdorura nga shkrimtarët arbëreshë, 5% të tjera janë neologjizmat e shkrimtarëve arbëreshë; rreth 25% e përbëjnë fjalët arbëreshe të katundeve të ndryshme, që nuk janë të përbashkëta me shqipen, po nuk duken të jenë as me burim të huaj. Më tej rreth 5% duket se janë fjalë me burim nga greqishtja, kryesisht të fushës së liturgjisë (një pjesë të sjella e një pjesë të marra në Kalabri e në Sicili nga rrethimi gjuhësor vendës); rreth 10% janë huazime nga dialektet e Italisë së Jugut ose nga italishtja e përbashkët. Nga kjo pasqyrë e mësipërme del se pjesa prej rreth 35% e leksikut arbëresh, që nuk është e përbashkët me shqipen e sotme, por as me prejardhje të qartë të huaj, duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi kritik të kujdesshëm nga ana e filologëve dhe leksikologëve kompetentë. Ato fjalë që do të kalojnë nga shosha e këtij shqyrtimi (dhe nuk do të jenë pak) do të fitojnë të drejtën e qytetarisë në gjuhën kombëtare shqipe dhe do të shërbejnë për pasurimin e saj.

Thirrja e E. Giordano-s për t'i hyrë shqyrtimit të imët të leksikut arbëresh, me qëllim që shqipja letrare kombëtare të pasurohet me fjalë e shprehje të reja, ende nuk është dëgjuar siç duhet. Në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe" (1980) janë shënuar me shkurtimin arb. (= fjalë e ligjërimëve arbëreshe) këto më poshtë: *e Bukura e Jetës, buzësumbull, -a; droqe, -t; fushamir/ë, -i; grep, -i; grykëkalbët; guff/ër, -ra; hor/ë, -a; kangjel/e, -ja; kez/ë, -a; lumbardh/ë, -a; mbar/ë, -a (e); mosnjeri; mosnjëherë; qafëz, -a; shqitëz, -a; zgjumth, -i*; në "Fjalorin e gjuhës shqipe" (2006) është shtuar edhe *shpargar, -i*. Kësaj liste të varfër prej 18 fjalësh mund t'i shtohet edhe folja *buthtoj*, e regjistruar që në "Fjalorin e gjuhës shqipe" (1954).

Ndërkaq botimi kohët e fundit i dorëshkrimit të fjalorit të arbërishtes të hartuar nga Kolë Kamsi (1886-1960) dhe i një vargu materialesh të tjera leksikore nga ligjërimet arbëreshe ose nga autorët arbëreshë e bën edhe më të mprehtë thirrjen e E. Giordano-s për vlerësimin e leksikut arbëresh dhe këtu nuk do të kemi para sysh kryesisht "ekzotizmat" arbëreshë (siç janë fjalët e sipërsënuara), por edhe fjalë që mund të dukeshin pa ngjyrim arbëresh, si *dashurisht, duhje* (diçka që na duhet, që kemi nevojë për të: "duhjet tona"), *lulësi, lulëzor, pandjenjësi* "apati", *përndreq* "restauror, riparor" etj.

"Fjalori i Arbëreshëve të Italisë" i Emanuele Giordano-s ka mbetur pak i përmendur e i vlerësuar në studimet tona gjuhësore, megjithëse ka shërbyer e shërben si një vepër konsultimi e pazëvendësueshme për leximin e teksteve letrare e të tjera të shkruara nga Arbëreshët në të kaluarën, po edhe në ditët tona. Ky fjalor nuk është studiuar ende si një vepër shkencore përfaqësuese e leksikut arbëresh dhe e ecurisë së zhvillimit të tij. Lënda e pasur dhe e dokumentuar që përmban fjalori, ofron një varg temash studimi të niveleve të ndryshme deri në një disertacion doktorate. Një studim përqsës me fjalorin e Kolë Kamsit do të ishte shumë i dobishëm: nga njëra anë, do të zbulonte veçoritë e secilit fjalor, nga ana tjetër, duke i parë të dy si plotësues të njëri-tjetrit, do të merrim një pamje më të plotë të leksikut arbëresh dhe të vlerave të tij për gjuhën e sotme.

Ky shkrim në kujtim të punëtorit të palodhur e të përkushtuar të gjuhës e të letërsisë shqipe, Mjeshtrit të Madh papas Emanuele Giordano, le të jetë një nxitje për të përmbushur një detyrë shkencore dhe për të nderuar emrin e tij.

1) Siç ma saktëson tashti i nipi Agostino Giordano.

2) Për këtë fjalor kanë botuar recensionet: Karl Gurakuqi, "Shëjzat" 7/1963, nr. 11-12, f. 421-424.; IdrizAjeti, "Gjurmime albanologjike" 1966, nr. 3, f. 247-249; JupKastrati, "Buletin i Institutit Pedagogjik Dvyeçar të Shkodrës", 1967, nr. 6, f. 497-501; Mahmut Hysa, "Fjala" 1969, nr. 4, f. 10-11.

3) Dihet se mungesa e turqizmeve në të folmet arbëreshe përbën një ngas dallimet që bien më shumë në sy me leksikon e shqipes së sotme. Megjithatë E. Giordano ka përfshirë në fjalorin e tij një varg turqizmesh që kanë depërtuar te autorët arbëreshë, si: *dushman*, *çorapë*, *dufek*, *halldup*, *nishan*, *raki*, *tel*, *topë* (top) etj.

4) Me gjithë dëshminë e A. Xhuvanit për përdorimin e kësaj fjale në Myzeqe, ajo njihet më fort si fjalë arbëreshe (shih. Eqrem Çabej, "Studime etimologjike në fushë të shqipes", Bleu II, Tiranë, 1976, f. 399); emri *buthitim* është përfshirë në terminologjinë e gjeologjisë me kuptimin "dalje e një shtrese në sipërfaqe" frëngj. *affleurement*.

5) Kolë Kamsi, "Fjalor arbërisht - shqip. Rreth 8600 fjalë e shënime gramatikore". Redaktor Ferdinand Leka. Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Sektori shkencor i albanologjisë. Shkodër 2000, 377 f.

Kontributi i “Fjalorit” të Emanuele Giordano-s në leksikografi

dr. Helena Grillo (Mukli)

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Fjalorët e tipeve të ndryshme - nga ata dialektorë të fjalorët normativë, nga ata terminologjikë të fjalorët sinonimikë, antonimikë e deri te fjalori frazeologjik - janë instrumente të rëndësishme të pasqyrimin të pasurisë së gjuhës shqipe në aspekte të ndryshme. Në këtë fazë të zhvillimit të shoqërisë njerëzore drejt globalizmit dhe të gjuhës shqipe në gjithë nënsistemet e saj është e nevojshme të hetohet zbatueshmëria e parimeve të hartimit të fjalorëve të sipërpërmendur, të cilët në llojin e vet sjellin risi në fushën e leksikografisë, si dhe polemika të ndryshme diskutimesh.

“*Fjalor i Arbëreshvet t’Italisë*” të Emanuele Giordanos nuk ka vetëm vlerat e një kodi leksikografik; ai përbën një vepër me rrezatim të gjerë, që vihet në dorë të të gjithë atyre që dëshirojnë të ngrenë kulturën gjuhësore dhe thellojnë njohjen e të folmeve dialektore të shqipes. Për më tepër Fjalori merr rëndësi të vecantë pasi sjell kontribut për njohjen e kulturës e botës arbëreshe, ruajtjen e zakoneve e traditave të të parëve.

